



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në zbatim të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 607, datë 31.08.2016, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 158, datë 05.10.2023, “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 48, datë 12.04.2017, Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

**1 (NJË) SEKRETAR/E**

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË**

1. Mbajtja e korrespondencës institucionale dhe dokumentacionit zyrtar të Drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet adresës zyrtare të institucionit;
2. Organizimi dhe mbajtja e agjendës së Drejtorit të Përgjithshëm;
3. Organizimin e takimeve, pritje e vizitorëve dhe komunikim me palët e treta.

**KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATIN**

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Bachelor";
2. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze;
4. Të ketë aftësi të mira komunikuese, të bashkëpunimit dhe të punës në grup,
5. Te mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Të mos jetë larguar nga detyrat e mëparshme me masë disiplinore.

**PAGA PËR POZICIONIN:** Klasa VI.

**DOKUMENTET E KËRKUARA**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, këto dokumenta:

1. Curriculum Vitae (CV);

2. Diploma e Arsimit të Lartë;
3. Kartë identiteti (fotokopje);
4. Dëshmi penaliteti (ose vetdeklarim);
5. Dëshmi për eksperiencë pune (librezë pune);

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës 05 Qershor 2026, ora 14:00, në adresën si në vijim: Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë, Shqipëri.